

NARTA LAGOON
Violeta Zuna
Medwet Coast 3 Project Coordinator

Parathenie

Laguna e Nartes ndodhet ne Rajonin e Vlores, Shqiperi. Eshte nje nga lagunat me te medha dhe te rendesishme ne Shqiperi. Laguna e Nartes ka nje siperfaqe ujore rreth 42 km², nga te cilat 13,8 km² shfrytezohen per prodhimin e kripes ne kriporen e Skrofotines. Thellesia e lagunes shkon nga 0.70 m ne 1.50 m. Miniera e kripes ne Narte eshte nje nga me te lashtat ne Ballkan dhe ne Shqiperi. Prodhimi i kripes deri ne 1990 ka qene 140-150 mije ton/vit. Pas viteve nentedhjete prodhimi ka qene 20-25 mije ton/ vit.




Laguna ne jug dhe jug-perendim kufizohet nga kodrat piktoreske te Zvernecit. Ne kete pjese te lagunes shtrihen dy ishuj,



ne ate me te madhen ndodhet Manastiri i Zvernecit.

Zona e Nartes eshte konsideruar si nje nga zonat lagunore me te rendesishme ne Shqiperi duke u bazuar ne vlerat e larta te biodiversitetit dhe ne numrin e habitateve te gjetura atje. Ekosistemi natyror i Nartes karakterizohet nga nje llojshmeri e pasur e habitateve si zona lagunore, delta e lumit Vjose, moçali kripor, dunat ranore, pyjet me pisha, ishulli i Zvernecit. Lidhjet midis tipeve te ndryshem te habitateve kane nje rendesi te madhe ekologjike.

Ne kendveshtrimin ekologjik ato krijojne shteg per migrimin dhe shperndarjen e bimeve dhe llojeve te kafsheve. Studimet mbi kete zone kane treguar rendesine e zones lidhur me interesimin dhe veçantine e flores. Ne shumelloyshmerine e madhe te habitateve, shume bime dhe lloje kafshesh jane te veçanta dhe ndodhen vetem ne kete zone bregdetare.



Zona e Nartes eshte e rendesishme jo vetem per llojet me te pershtatura, por gjithashtu per nje numer te madh llojesh me pak te pershtatura dhe karakteristike



Te gjitha keto lloje bimesh perbejne nje pasuri te madhe kombetare me vlera ekonomike dhe shkencore. Disa prej tyre jane shume te rralla, disa te tjera kane vlera shkencore, dhe pjesa me e madhe e tyre perbejne grupin per perdorim te gjere ekonomik siç jane bimet mjeksore, aromatike, ato per industrine ushqimore dhe bime dekorative. Shume lloje te kesaj zone jane

gjetur ne Librin e KUQ te Shqiperise.

Pjesa me e madhe e zogjve, afersisht 91%, ndodhen kryesisht ne ujrat e lagunes. Ato jane shperndare uniformisht ne lagune dhe kane koncentrim te larte ne qendren e saj, e cila eshte gjithashtu dhe nenzona me pak e trazuar.

Rosat (Anas sp.) dhe Bajza (*Fulica atra*) zene numrin me te madh me perkatesisht 47 % (18000individive) dhe 35% (13500 individive).



Nga te dhenat e viteve te fundit thone se zona e Nartes eshte vendi e dyte me i rendesishem per zogjte ujore ne Shqiperi, Karavastaja ze vend te pare. Ne dimer me shume se 23 % te gjithe zogjve ujore te Shqiperise gjejne strehim ne kete zone. Me shume se 35 lloje te zones mbajtese me shume se 6% te efektivit kombetar. Narta eshte vendi kryesor i dimerimit ne Shqiperi per flamingot (*Phoenicopterus ruber roseus*), rosa laramane (*Tadorna tadorna*), rosa bishegjele (*Anas acuta*), rosa sykalter (*Bucephala clangula*, vraponjesi gushebardhe (*Charadrius alexandrinus*) dhe gjelezen pikaloshe (*Pluvialis squatarola*). Ja vlen te permendet prania e pelikanit Dalmat (*Pelecanus crispus*) (9%) dhe pulbardhes se Audouinit *Larus audouinii* (100%), te dy konsiderohen lloje ne rrezik zhdukje boterore

Zona e Nartes eshte gjithashtu nje vend me rendesi nderkombetare. Ajo permbush kriteret e Ramsar (ligatina te rendesise nderkombetare) per sasine e zogjve qe dimerojne me me shume se 48.700 individive (20.000 individive qe jane ne kriteret e Ramsarit) Per tre lloje zona mban me shume se 1% te popullimit rajonal.